



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.31, datë 26.12.2023

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT NR.27,  
DATË 16.03.2022 “PËR MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:  
“VLORA MARINA RESORT, HOTEL DHE STRUKTURË AKOMODUESE  
REZIDENCIALE”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË VLORË

Në mbështetje të neneve 7 pika “ç”, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Marina Residences Vlorë” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e Vendimit të KKT-së Nr.27, datë 16.03.2022 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Vlora Marina Resort, Hotel dhe Strukturë akomoduese rezidenciale”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Marina Residences Vlorë” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantw, që përmenden në pikën 2, të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.27, datë 16.03.2022 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: Vlora Marina Resort, Hotel dhe Strukturë akomoduese rezidenciale”, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Marina Residences Vlorë” sh.p.k.
3. , zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDH RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
BELINDA BALLUKU



SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 12/08 / 2024